

# Udhëzues për... krijimin e një grupi leximi

Në Mbretërinë e Bashkuar janë 500,000 personat që janë grupuar në grupe leximi. Popullariteti i tyre është zgjeruar dhe përfshin të gjitha sferat e jetës, të gjitha moshat, etnitë, nga grupet për personat me probleme shikimi e deri te bijtë e baballarët. Kjo tregon se si mund të përdoret kjo ide nga njerëz të ndryshëm sipas situatave dhe interesave të tyre.

## ÇFARË JANË GRUPET E LEXIMIT?

Grupi i leximit mund të përbëhet duke filluar nga një dorë miqsh që takohen në një kafene ose në shtëpinë e dikujt dhe diskutojnë për një ose disa libra. Edhe bibliotekat janë vende të shkëlqyera për t'u takuar, ku mund të takoni njerëz të ndryshëm dhe disa prej këtyre bibliotekave mbajnë kopje të shumta librash vetëm për këtë qëllim. Grupet e leximit mbledhen edhe në librari, në spitale, pabe, grupe besimi, madje edhe në ambientin e punës. Disa prej këtyre grupeve janë të përgjithshme, por të tjerë përqendrohen në një zhanër ose lloj publikimi të caktuar, si romane kriminale, libra nga shkrimtare femra, poezi ose libra klasikë.

## ÇFARË QËLLIMI KA KJO?

Përveç aspektit social të shoqërimit me persona të tjerë duke pirë një çaj, kafe apo diçka tjetër, është e natyrshme dëshira për të diskutuar për një libër që mund të të ketë prekur ose frymëzuar. Grupet e leximit të inkurajojnë të mendosh më shumë për një libër dhe të dëgjosh këndvështrime të ndryshme. Ç'është më e mira, në këto grupe mund të njihesh me një shumëllojshmëri autorësh dhe literature që më parë mund të mos të të kishte shkuar mendja t'i lexoje.

## SI TË GJEJ NJË GRUP LEXIMI PRANË VENDIT KU BANOJ?

Nëse dëshiron të bashkohesh me një grup ekzistues leximi, ekzistojnë mënyra të ndryshme për të gjetur se ku të shkosh:

- Biblioteka lokale
- Faqet e internetit siç janë [www.bookgroup.info](http://www.bookgroup.info), dhe [www.readinggroups.peoplenetwork.gov.uk](http://www.readinggroups.peoplenetwork.gov.uk)
- Organizatat vullnetare dhe grupet e kujdesit.

Në internet ka shumë grupe leximi në linjë të cilat organizohen nga revista dhe organizata të tilla si 'Book Army' ([www.bookarmy.com](http://www.bookarmy.com)), shtëpi botuese si Penguin Books (<http://readers.penguin.co.uk>) dhe sigurisht stacione TV dhe radio ku përmendim Radio 4 (Open Book dhe Book Club) si dhe TV Book Club ([www.tvbookclub.co.uk](http://www.tvbookclub.co.uk)).

## SI TA ORGANIZOJ VETË NJË GRUP LEXIMI?

Mënyra si mund ta arrish këtë varet nga ajo që kërkon nga grupi i leximit. Grupet e leximit mund të bëhen formale apo joformale, sipas dëshirës tënde. Pyet shokët ose persona që i sheh në grupet apo klubet e tjera lokale për të parë nëse dëshirojnë të bashkohen me ty. Caktoni një vend takimi (nuk është e nevojshme që të jetë përherë në një vend), një orar dhe vendosni se sa shpesh do të takoheni. Takimet një herë në muaj janë më të zakonshmet.

## SI TË VENDOSIM SE ÇFARË TË LEXOJMË?

Zakonisht zgjidhet një libër në muaj dhe secili pjesëtar i grupit sugjeron sipas radhës një libër tjetër. Megjithatë, disa grupe preferojnë të lexojnë libra të ndryshëm dhe më pas flasin për atë që kanë lexuar dhe dëgjojnë zgjedhjet e të tjerëve. Varet nga ju, por nëse të gjithë dëshironi të lexoni dhe të komentoni pikëpamjet tuaja mbi të njëjtin libër, ekzistojnë mënyra të ndryshme për të nxjerrë ide:

- Zgjidhni libra sipas temës, siç janë librat klasikë, libra për pushime, tregime të shkurtra ose libra nga fëmijëria

- Nga listat e letërsisë artistike bashkëkohore në bibliotekën tuaj lokale, nga listat e librarive dhe bestsellerëve në gazeta ose në internet

- Nga analizat e librave nëpër gazeta e revista

- Nga nominimet për çmimet e letërsisë siç janë Çmimi Orange ose Çmimi Costa të cilat përmenden zakonisht në shtyp.

Madje nuk është e nevojshme të flisni për librat. Për të filluar, mund të diskutoni për një artikull reviste apo gazete, tregime të shkurtra ose diçka nga interneti.

## PËR ÇFARË TË FLASIM?

Kjo varet nga ju. Thjesht flisni për të parë se ku shkon diskutimi. Për të nisur mund të filloni të flisni për reagimet emocionale për librin, për karakteret, sa të besueshëm janë, mesazhet apo temat kryesore, pjesët më mbresëlënëse, pikat e forta e të dobëta.

## A NUK KUSHTON SHUMË TË BLESH VAZHDIMISHT LIBRA?

Nëse të gjithë lexoni të njëjtin libër njëkohësisht, do të thotë se do ju duhet t'i blini ato. Prandaj, shumë grupe përqendrohen te librat me cilësi më të ulët letre dhe është ide e mirë të kërkojnë ofertat në librari dhe në internet. Disa librari dhe shitësit në internet ofrojnë ulje të mira në çmim nëse blen disa libra. Pyet në bibliotekën lokale se cilët libra i kanë me shumë kopje dhe kërko që t'i rezervosh ato në kohën e duhur.

Ekziston dhe opsioni i diskutimit të dy librave në një takim, dhe më pas mund t'i shkëmbeni me njëri-tjetrin në mënyrë që të blesh vetëm një çdo dy muaj (ose si ta keni caktuar shpeshësinë e takimeve) dhe jo çdo muaj. Librat mund të jenë nga i njëjti autor për shembull, ose të flasni për të njëjtën temë në mënyrë që gjatë herën tjetër të krahasoni dhe bëni kontrastet mes librave.

## A KA NDONJË RREGULL TË VEÇANTË PËR TË DREJTUAR NJË GRUP LEXIMI?

Është shkruar shumë për këtë temë dhe disa organizatat dhe tituj librash tregohen më poshtë. Por e gjitha varet nga sa seriozisht e merrni këtë punë. Është e këshillueshme të caktohet një drejtues për qëllime organizimi dhe për të nxitur debatin.

Disa grupe ndjekin linja strikte, por shumë grupe zhvillojnë bashkëbisedime të lira për argëtim. Disa sugjerojnë mbajtjen shënimi të pikave kryesore gjatë takimit në mënyrë që t'u ktheheni më pas e të kujtoni atë që u tha, por kjo nuk është e nevojshme përveçse nëse dëshironi të diskutoni të njëjtin libër gjatë takimit të ardhshëm.

Megjithatë, vlen të kihen parasysh disa pika, si për shembull:

- secili të ketë radhën e vet për të zgjedhur materialin për të lexuar,
- secilit t'i jepet mundësia të dëgjohet gjatë diskutimit dhe
- të gjithë të jenë të kujdesshëm me ndjenjat dhe situatat e të tjerëve.

## LIBRA DHE ORGANIZATA

The Reading Agency  
National Literacy Trust  
BBC Raw  
Bookgroup.info  
*Reading Groups* nga Jenny Hartley, Sarah Turvey  
*The Reading Group* nga Liz Noble  
*The Reading Group Handbook* nga Rachel W Jacobsohn



# Bookbite